



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 109/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi për ankesën e Bekë Berisha në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Bekë Berisha në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 31.01.2011, nga Bekë Berisha me nr. 85 në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendohet se:

- Në ditën e rivotimit në komunën e Mitrovicës me 23.01.2011 kandidati ka qëndruar tërë ditën në Mitrovicë dhe është informuar në hollësi për numrin e votave të fituara si kandidat andaj është i sigurt se në Mitrovicë në qendrat e votimit: në shkollën "Ismajl Qemajli", në shkollën "Migjeni", në shkollën "Anton Zako Çajupi", në shkollën "Bedri Gjinaj", në shkollën "Skënderbeu", në fshatin Vaganicë, në fshatin Vllahi, në fshatin Shalë e Bajgore, në fshatin Vidomeriq, në shkollën "Elena Gjika", në qendrën e votimit në Stan Tërg, në shkollën "Trepça" ka fituar rreth 600 vota (plus-minus 20 vota). Nga të dhënat që i ka marrë nga Këshilli Komunal Zgjedhor (KKZ) në Mitrovicë thuhet se ka fituar vetëm 169 vota.
- Në bazë të informatave të konfirmuara sipas parashtruesit të ankesës nga aktivistët në teren, vëzhgues dhe komisionar pranë qendrave dhe vendvotimeve votat për kandidatin me nr. 85 janë manipuluar nga njerëz të caktuar, nëpër këto vendvotime dhe pasqyrat e dhëna deri më tani nuk janë reale andaj jam i detyruar që nga PZAP-i të kërkoj rinumërimin e fletëvotimeve të subjektit politik AAK në mënyrë që vullneti i qytetarit të ve në shprehje dhe vota të shkojë aty ku takon. Kandidati në fjalë thekson se janë mbi 600-650 vota kurse janë raportuar dhe regjistruar në Formulari e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formulari i Rezultateve për Kandidat (FRK), vetëm 455 vota. Këto shkelje kanë të bëjnë në të gjitha qendrat e votimit në komunën e Deçanit në rivotimin e 9 janarit 2011. Qendrat e Votimit (QV): 0101c në Deçanit, 0101x në Carrabreg, 0102c në Drenas, 0103c në Gramaqel, 01015c në Strelc, 0106c në Irzniq, 0108c në Isniq dhe 0110c në Lumëbardh. Më tej parashtruesi i ankesës thekson se ka kërkuar në bazë të vendimit të KQZ si kandidat nga zyrtarët e KKZ në

Deçan për kopjen e FPR-ve dhe FRK-ve për të krahasuar rezultatin e paraqitur dhe t'ia bashkoj si dëshmi kësaj shkrese por një gjë e tillë është penguar nga kryetari i KKZ në Deçan, Xhavit Rexhahmetaj.

- Në bazë të informatave të konfirmuara sipas parashtruesit të ankesës nga aktivistët në teren, vëzhgues dhe komisionar pranë qendrave dhe vendvotimeve votat për kandidatin me nr. 85 janë manipuluar nga njerëz të caktuar, nëpër këto vendvotime dhe pasqyrat e dhëna deri më tani nuk janë reale andaj jam i detyruar që nga PZAP-i të kërkoj rinumërimin e fletëvotimeve të subjektit politik AAK në mënyrë që vullneti i qytetarit të vjenë në shprehje dhe vota të shkojë aty ku takon. Kandidati në fjalë thekson se në të gjitha vendvotimet në këto QV në komunën e Klinës në votimin e 12 dhjetorit 2010. QV 0806 në Budisllacë parashtruesi i ankesës thekson se ka marrë 57 vota ndërsa i janë regjistruar vetëm 25 vota, në QV 0804 në Zllakuqan parashtruesi i ankesës thekson se i ka marrë mbi 60 vota ndërsa i janë regjistruar vetëm 13 vota në QV 0811 në Grabanicë kandidati thekson se i ka marrë mbi 30 vota ndërsa i janë regjistruar vetëm 11 vota, në QV 0816 në Gremnike parashtruesi i ankesës thekson se i ka marrë mbi 31 vota ndërsa i janë regjistruar vetëm 1 votë dhe QV 0801 në Klinë parashtruesi i ankesës thekson se i ka marrë mbi 150 vota ndërsa i janë regjistruar vetëm 32 vota. Në total parashtruesi i ankesës potencon se i ka grumbulluar më shumë se 300 vota, ndërsa i janë regjistruar në FPR dhe FRK dhe janë dorëzuar QNR-së dhe KQZ-së vetëm 125 vota.
- Sipas parashtruesit të ankesës në bazë të informatave të konfirmuara në teren nga vëzhgues dhe komisionar pranë Qendrave dhe Vendvotimeve votat e kandidatit me nr. 85 janë manipuluar nga njerëz të caktuar nëpër këto QV: 0208c fshati Bishtrazhin shkolla "Gjergj Fishta" ku sipas parashtruesit të ankesës ka më shumë se 100 vota, 0209 në fshatin Lipovec shkolla "Niman Ferizi" ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 40 vota, 0213c në fshatin Demjan shkolla "Durak Ahmeti" ku sipas parashtruesit të ankesës ka rreth 25 vota, 0219c në Novosellën e Epërme shkolla "Shtjefën Kurti" ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 90 vota, 0220c në fshatin Jabllanicë shkolla "Dëshmorët e Kombit" ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 20 vota, 0224c në fshatin Doblbarë shkolla "Remzi Pula" ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 30 vota, 0225c në fshatin Mulliqë shkolla "Jahë Salihu" ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 30 vota. Në QV në qytetin e Gjakovës, 0203c, 0203x, 0201c ku sipas parashtruesit të ankesës ka mbi 59 vota. Në total parashtruesi i ankesës potencon se numri i votave del 419, ndërsa në FPR/FRK të dorëzuara pas ditës së votimit ka pas vetëm 304 vota që do të thotë sipas parashtruesit të ankesës është dëmtuar për rreth 115 vota.
- Parashtruesi i ankesës kërkon hapjen e kutive të votimit në dy QV në komunën e Istogut, në fshatin Uçë, vendvotimit nr.1 ku për shkak të një gabimi nga ana komisionarit 13 vota të kandidatit me nr. 85, i janë shkruar një kandidati tjetër. Ndërsa në QV në Ratkosh, nga gabimi i komisionarit, 28 vota ta kandidatit nr.85 i janë shkruar kandidatit me numër 84 ose 86.

Në shkresën e KQZ-së të datës 01.02.2011 me nr. 194-2011 lidhur me rastin e lart përmendur, për pretendimet e ankuesve për pasqyrimin jo real të rezultateve të zgjedhjeve të shpallura nga KQZ-ja 30.01.2011 në procesin e votimit për Kuvendin e Kosovës me 12.12.2010 dhe rivotimit më 09 dhe 23 Janar 2011 në komuna të caktuara KQZ-ja ju njoftoj PZAP-in në vijim: Procesin e votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhura për Kuvendin e Republikës së Kosovës e ka përshkuar një proces i gjatë dhe gjithë përfshirës i kontrollimit auditivit dhe verifikimit të saktësisë së dhënave dhe rezultateve. Për shkak të mospërputhjeve të konstatuara – numrit të fletëvotimeve të hedhura në Kutitë e votimit dhe numri i votuesve në Listen Përfundimtare të Votuesve (LPV) mbi nivelin plus-minus 6 dhe parregullsive tjera, 760 vendvotime i janë nënshtruar procesit të rinumërimit të votave të zgjedhjeve të 12.12.2010, në 92 vendvotime në zgjedhjet e 09 Janarit 2011 dhe 38 vendvotimet në zgjedhjet e 23 Janarit 2011.

Procesi i rinumërimit të votave në këto vendvotime ka qenë transparent dhe është zhvilluar në praninë e vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuara, mediave, faktorit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me këshilltarët e IFES-it.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

- (c) *118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Sipas PZAP-it pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara nga shkaku se kërkesat e të njëjtit, të cilat i kërkon për vërtetimin, hapjen e kutive dhe numërimin e votave, duke pretenduar se janë manipuluar votat në Qendrat e Votimit të theksuara në ankesë nuk qëndrojnë, ngase i njëjti pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në asnjë provë të vetme materiale për ti dëshmuar shkeljet e pretenduara në ankesë. Për më tepër, parashtruesi i ankesës nuk ka shpjeguar se në çfarë forme KKZ në Deçan ka refuzuar t'i sjellë dëshmitë e kërkuara, si dhe nuk ka bashkangjitur ndonjë kërkesë formale drejtuar këtij institucioni zgjedhor në nivel komunal për të dëshmuar të kundërtën. PZAP vlerëson se e gjithë ankesa e kandidatit për deputet është e bazuar në pohimet e tij personale dhe të pabazuara në fakte.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 109/2011 më datën 02.02.2011

